



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:176844
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509305

CN.nr.4/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm e përbërë nga Gjyqtari Individual Besnik Feka, në çështjen kontestimore të paditesit A.G. nga fshati A./Komuna e L., të cilin me autorizim e përfaqëson V. M. , avokat nga L., kundër të paditurës B. M., me parë nga Peja, rr. xxxx e tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson, përfaqesuesi i përkohëshëm V. Z., av. nga Lipjani, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, duke vendosur sipas propozimit për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga e paditura B.M. nga Peja, të cilën me autorizim e përfaqëson avokate Xh. K. nga Prishtina, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.762/2022, i datës 04.07.2023, me datë **26.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si i palejuar propozimi për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga e paditura B. M. nga Peja, ushtruar përmes të autorizuarës së saj, avokate Xh. K. nga Prishtina kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.762/2022, i datës 04.07.2023.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.762/2022, datë 04.07.2023, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurës për zgjidhjen e martesës ka vendosur si në vijim:

I.ZGJIDHET martesa me shkurorëzim e lidhur me datën 10.05.2018, në Zyrën e Gjendjes Civile në Lipjan, e regjistruar në LAM me nr. rendor 115 dhe numër të referencës 13/2018 RM/13001, në mes të paditësit A.G, i lindur me data 19.01.1973 në fshatin A., nga i ati U dhe nena H. dhe të paditurës B. G., e vajzërisë M, e lindur me data 20.06.1977, në Pejë, nga i ati S. dhe nëna M, në bazë të nenit 68, të Ligjit për Familjen e Kosovës.

II. OBLIGOHET paditësi që përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurës, av. Valdet Zeqiri, nga Prishtina, të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shume prej 239.20 euro brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, dhe pas kalimit të afatit për ushtrimin e mjetit juridik ky aktgjykim ishte bërë i plotëfuqishëm me datën 12.08.2023.

Ndaj aktgjykimit në fjalë, e paditura B. M. nga P, përmes të autorizuarës së saj, avokate Xh K. nga P., ka paraqitur propozim për përsëritje të procedurës, duke propozuar që Gjykata e Apelit, të aprovoj propozimin, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloj ashtu që të lejohet përsëritja e procedurës dhe dosja e lëndës të i dërgohet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të përsëritjes.

Propozimi për përsëritje të procedurës i është dorëzuar me kohë palës paditëse, e cila brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në propozimin për përsëritje të procedurës, duke e kundërshtuar të njëjtin, me propozim që pala e paditur ishte në dijeni të zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit dhe mbi bazën e të gjitha arsyeve të dhëna, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj të pa bazuar propozimin për përsëritje të procedurës.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit në kuptim të nenit 235 dhe 239.1 të LPK-së, lidhur me nenin 88 të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimit për përsëritjen e procedurës së parashtruar nga e paditura Komuna e Shtërpcës, gjeti se:

Propozimi për përsëritjen e procedurës i të paditurës B. M. nga P, ushtruar përmes të autorizuarës së saj, avokate Xh. K. nga Prishtina, është i pa lejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A. G. nga fshati A./Kmuna e L, me vendbanim aktual në Gj, përmes të autorizuarit të tij, avokat V. M. nga Lipjani me datën 20.08.2022, ka ushtruar padi për shkurorëzim kundër të paditurës B. M. nga P, me vendbanim në Gj.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, e ka zhvilluar procedurën dhe ka marrë aktgjykim C.nr.762/2022, i datës 04.07.2023, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit me të cilin ka zgjidhur martesën mes palëve, dhe ndaj të cilit kërkohet përsëritja e procedurës.

Gjykata e Apelit-Gjyqtari Individual, fillimisht duke u kujdesur për lejueshmërinë e parashtrimit të propozimit për përsëritje të procedurës, ka vlerësuar propozimin për përsëritje, se kërkesa bazohet në nenin 232 paragrafi 1, pika a) dhe b) të LPK-së, por konsideron se propozimi për përsëritjen e procedurës nuk është i lejuar. Në rastin konkret nuk mund të gjejnë zbatim as dispozitat e nenit 232 paragrafi 1, pika a) dhe b) LPK-së, sepse me nenin 88 të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, ligj special, përcaktohet se *“Nëse martesë është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurorëzimin, përkatësisht për anulimin e martesës nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike”*. Andaj në rastin konkret për Gjykatën e Apelit, përsëritja e procedurës nuk është e lejuar, dhe meqë, këtë propozim gjykata e shkallës së parë nuk e ka hudhë poshtë si të pa lejuar konform nenit 237 par.1 të LPK-së, atëherë, gjykata e shkallës së dytë, konform nenit 239 paragrafi 1, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke hedhur si të palejuar propozimin për përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CN.nr.4/2024, me datë 26.03.2024

Gjyqtari Individual

Besnik Feka

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Trupit Gjykses të Gjykatës së Apelit në Prishtinë.